



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0656

Paneli Shqyrtues, i caktuar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE “AAB CONSTRUCTION” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me numër të prokurimit; 616-25-1686-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më 09/09/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “AAB CONSTRUCTION” SH.P.K. me nr. 2025/0656, e datës 16/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza”, me numër të prokurimit; 616-25-1686-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Komuna Prishtinë.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza”, me numër të prokurimit; 616-25-1686-5-2-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE “AAB CONSTRUCTION” SH.P.K. i konfiskohet tarifa e sigurimit ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 11.03.2025, Komuna Prishtinë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me numër të prokurimit 616-25-1686-5-2-1, ndërsa me datën

03.07.2025 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58. "N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ; N.T.P. DAQA "

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00€.

Me 07.07.2025, OE "AAB CONSTRUCTION" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 08.07.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16/07/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga "AAB CONSTRUCTION" SH.P.K me nr. 2025/0656 lidhur me aktivitetin "Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza" me numër të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim:

REFUZOHETKërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AAB Construction shpk" të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza" me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.

Operatori ekonomik "AAB Construction shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 07.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza" me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meriturri) të kërkesës.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AAB CONSTRUCTION" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Te pa kënaqur me njoftimin e date 07.07.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza me nr. te prokurimit: 616-25-1686-5-2-1 ne afatin ligjor konform ligjit, ushtrojmë këtë: Për shkak se AK- KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS:

? Me datë 03.06.2025 është marrë vendimi i parë nga Autoriteti Kontraktues, vendim me të cilin është shpallur fituese kompania N.T.P. “Lulishtja Buçaj; N.P.T. Daqa”.

Pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, lënda është kthyer në rivlerësim, dhe pas këtij rivlerësimi, sërish është shpallur fituese e njëjta kompani, ndonëse ajo është dashur të eliminohej për faktet si më poshtë:

Gjatë vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues (AK) nuk e ka marrë në konsideratë Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Nenin 61, që ka të bëjë me Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Kjo shkelje bie ndesh me dispozitat ligjore që përcaktojnë qartësisht se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, AK është i obliguar të identifikojë dhe të trajtojë ofertat që mund të konsiderohen jo-normalisht të ulëta sipas kritereve të përcaktuara.

Si rrjedhojë, mungesa e respektimit të këtij neni mund të ndikojë në:

1. Cilësinë e vlerësimit: Duke mos bërë një analizë të mjaftueshme për të konstatuar nëse ofertat e pranuar përbushin kriteret e përcaktuara.

2. Sigurimin e konkurrencës së drejtë: Një mosvlerësim i tillë mund të rezultojë në përzgjedhjen e ofertave që nuk janë të qëndrueshme ose që mund të cenojnë standardet e prokurimit publik.

Është e rëndësishme që AK të rishikojë procesin e vlerësimit dhe të sigurohet që të gjitha ofertat të shqyrtohen në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara nga LPP dhe udhëzuesit përkatës.

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Neni 61, që trajton Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, si dhe në Udhëzuesin Nr. 002/2024, për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, Neni 11, është konstatuar se oferta përbush kushtet për tu konsideruar si ofertë jo-normalisht e ulët. Argumentimi për përbushjen e kushteve është si vijon:

Kushti i parë: Është përbushur, pasi janë pranuar gjithsej katër (4) oferta, duke përbushur kriterin minimal të numrit të ofertave

Kushti i dytë: Të gjitha ofertat nën çmimin mesatar përbushin pragu prej 30%, që llogaritet si mesatarja / 1.3. Në këtë rast, oferta juaj përbush këtë kusht, pasi çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja e ofertave të pranuar.

Kushti i tretë: Lidhur me krahasimin mes ofertës më të lirë dhe ofertës së dytë më të lirë, pragu prej 10% është llogaritur si oferta e dytë / 1.1. Edhe në këtë rast, oferta juaj plotëson këtë kusht, pasi çmimi i saj është më shumë se 10% më i ulët se oferta e dytë më të lirë.

Bazuar në analizën e mësipërme, është konstatuar se oferta e paraqitur përbush të gjitha kriteret dhe mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet në fuqi. Kushti 1 N.T.P Lulishtja Buçaj; N.P.T.Daqa € 88,190.00 AAB Construction SHPK € 128,800.00 DachGroup & Harst Group & Mehmet Muçiqi € 146,827.00 N.SH.T. Viktory € 171,085.00 Totali I ofertave € 534,902.00 Mesatarja/4 € 133,725.50 Kushti 2 Pragu(30%)(mesatarja/1.3) € 102,865.77

? Pas rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues me datën 01.07.2025- ka dërguar B47-Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit Konkursiumit N.T.P Lulishtja Buçaj; N.P.T.Daqa ku në mënyrë të

kundërligjshme ka kërkuar dokumente shtesë nga kompania në fjalë – dokumente të cilat nuk janë dorëzuar gjatë fazës së ofertimit.

Më saktësisht, për të përmbushur kriterin:

2.11 – Operatorët Ekonomikë duhet të kenë së paku tre (3) punëtorë të trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës,

Kompania në fjalë kishte dorëzuar disa dokumente shtesë për të tentuar përmbushjen e sqarimit të AK-së, konkretisht certifikata të cilat në asnjë mënyrë nuk e plotësojnë kërkesën e përcaktuar në kriterin 2.11.

Megjithatë, pas rivlerësimit, AK ka kërkuar dokumente shtesë me pretekstin e "vazhdimin të kontratave të punës për tre punëtorë" pasi që ne i kemi i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim nr.1-pasi që kontratat kanë qenë me validitet deri më 31.12.2024..

Në këtë rast, OE ka bashkëngjitur kontratat e punës të vazhduara për periudhën 31.12.2024-31.12.2025 dhe, krahas tyre, edhe certifikata shtesë për këta tre punëtorë – prej të cilave dy nuk kanë qenë të dorëzuara me rastin e ofertimit fillestar (gjatë dorëzimit të ofertave ka dorëzuar ISO 9606-1:2018 Certifikata të cilat nuk kanë të bëjnë fare me trajnimin për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës).

Ndërsa pas kërkesës për sqarim ka prezantuar certifikatat të cilat janë dorëzuar pas afatit dhe nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit origjinal të ofertës. Me pretekstin e bashkëngjijtes së kontratave, OE ka shtuar certifikata të reja, të cilat sipas dispozitave të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, nuk mund të pranohen.

Kjo përbën shkelje të qartë të rregullave të prokurimit, pasi AK nuk ka të drejtë të pranojë dokumente të reja që nuk janë dorëzuar me ofertën fillestare.

Sipas ligjit, rregullores dhe udhëzuesit përkatës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë vetëm sqarime ose informacione shtesë lidhur me dokumentet që janë dorëzuar me rastin e ofertimit, por jo të pranojë dokumente të reja siç ka vepruar duke i rikërkuar kontratat të cilat janë të vazhduara

Prandaj, pranimi i certifikatave të reja nga AK pas ofertimit është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 72 – “Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.” i cili lejon kërkesën për sqarime vetëm mbi dokumentet ekzistuese të dorëzuara me ofertë, dhe në asnjë rast paraqitjen e dokumenteve të reja.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve,

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

? Në dosjen e tenderit është kërkuar, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (kërkesa 2.11), është kërkuar që të ofrohen së paku 3 punëtor të trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës, ku ka prezantuar:

-Ibrahim Morina – për punëtorin në fjalë ka prezantuar certifikatën ndërsa kontrata e punës është një kontratë për kohë të caktuar e cila ka skaduar më -31.12.2024.

-Idriz Krasniqi nuk përmbush kërkesën pasi që për kërkesën (2.11 – Operatorët Ekonomikë duhet të kenë së paku tre (3) punëtorë të trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës) certifikata e prezantuar për këtë kërkesë është ISO 9606-1:2018 ndërsa ISO 9606-1:2018 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për testimin dhe certifikimin e aftësive të saldatorëve për saldimin me dorë të materialeve metalike- nuk ka të bëjë fare me manovrimin e mjeteve të punës si dhe i njëjti punëtor kontratën e punës ka një kontratë e cila është për kohë të caktuar e cila ka skaduar më -31.12.2024. Certifikatat e dorëzuara pas sqarimeve shtese nga ana e Operatorit Ekonomik (OE) janë paraqitur në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Duke qenë se OE nuk i ka përmbushur kërkesat me dokumentet e ofertimit fillestar, ka dorëzuar më pas certifikata të reja, konkretisht certifikatat për punëtorët e trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës, me qëllim përmbushjen artificiale të kriterit për punëtorët e trajnuar. Këto certifikata janë dorëzuar pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues për sqarim lidhur me kontratat e punës (të cilat, gjithashtu, ishin të pavlefshme), por OE ka shfrytëzuar këtë mundësi për të bërë manovrim dhe për të bashkangjitur certifikata të reja, të cilat nuk ishin as pjesë e kërkesës për sqarim dhe nuk ishin dorëzuar me ofertën fillestare.

Prandaj, pranimi i certifikatave të reja nga AK pas ofertimit është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 72 – “Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.” i cili lejon kërkesën për sqarime vetëm mbi dokumentet ekzistuese të dorëzuara me ofertë, dhe në asnjë rast paraqitjen e dokumenteve të reja. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve,

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet

dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

-Musa Krasniqi nuk përmbush kërkesën pasi që për kërkesën (2.11 – Operatorët Ekonomikë duhet të kenë së paku tre (3) punëtorë të trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës) certifikata e prezatuar për këtë kërkesë është ISO 9606-1:2018 ndërsa ISO 9606-1:2018 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për testimin dhe certifikimin e aftësive të saldatorëve për saldimin me dorë të materialeve metalike- nuk ka të bëjë fare me manovrimin e mjeteve të punës si dhe i njëjti punëtor kontatën e punës ka një kontratë e cila është për kohë të caktuar e cila ka skaduar më - 31.12.2024. Certifikatat e dorëzuara pas sqarimeve shtese nga ana e Operatorit Ekonomik (OE) janë paraqitur në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Duke qenë se OE nuk i ka përmbushur kërkesat me dokumentet e ofertimit fillestar, ka dorëzuar më pas certifikata të reja, konkretisht certifikatat për punëtorët e trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës, me qëllim përmbushjen artificiale të kriterit për punëtorët e trajnuar.

Këto certifikata janë dorëzuar pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues për sqarim lidhur me kontratat e punës (të cilat, gjithashtu, ishin të pavlefshme), por OE ka shfrytëzuar këtë mundësi për të bërë manovrim dhe për të bashkangjitur certifikata të reja, të cilat nuk ishin as pjesë e kërkesës për sqarim dhe nuk ishin dorëzuar me ofertën fillestare.

Prandaj, pranimi i certifikatave të reja nga AK pas ofertimit është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 72 – “Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.” i cili lejon kërkesën për sqarime vetëm mbi dokumentet ekzistuese të dorëzuara me ofertë, dhe në asnjë rast paraqitjen e dokumenteve të reja.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve,

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

? Sipas Ligjit të Punës në Kosovë, një kontratë pune lidhet vetëm me një punëdhënës. Në një kontratë të vetme, punëdhënësi duhet të jetë një kompani dhe jo dy kompani, ashtu siç është paraqitur në këtë procedurë. Kjo situatë duket të jetë në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe mund të konsiderohet si mosrespektim i kërkesave të dosjes së tenderit.

Në rastin e konsorciumit, është praktikë e zakonshme që njëra nga kompanitë anëtare të përcaktohet qartë si punëdhënësi për stafin e angazhuar në projekt. Kjo siguron qartësi dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe të tenderit. Duke qenë se kërkesa e dosjes së tenderit për kontratat e punës nuk është

përbushur në mënyrë adekuate, oferta nuk mund të konsiderohet e vlefshme dhe duhet të refuzohet.

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

? Në dosjen e tenderit është kërkuar, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (kërkesa 2.1), është kërkuar që të ofrohet për menaxherin e projektit edhe certifikata që është i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë në certifikatën e prezantuar është një certifikatë e cila është e datës 10.01.2022- certifikatë jo valide pasi që sipas Ligji Nr. 04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë si dhe Rishikimi i vlereësimit të riskut në vendin e punës duhet të bëhet jo me pak së një herë në dy vite certifikatat e tilla janë certifikata të cilat kanë vlefshmëri prej 2-viteve e në rastin konkret kjo certifikatë ka skaduar në vitin 2024.

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit

? Në dosjen e tenderit është kërkuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesa

6. Për paisjet -që të ofrohet një Kamion kiper me kran me peshe ngarkese max. 1.5 tonë- në këtë procedurë ky GOE ka ofruar marrëveshje me Sh.Zejnullahu paisjen e cila nuk përbushë kërkesën pasi që ka prezantuar Kamionetë kiper me vinq dhe jo Kamion sipas kërkesës në dosjen e tenderit.

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

? Në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohen certifikatat ISO 45001-2018-, ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, ISO 39001-2012, Lulishtja Buqaj nuk ka prezantuar certifikatën valide ISO 39001-2012, për shkak se në vet certifikatën e bashkëngjitur është e shkruar qartë se kjo certifikatë mbetet e vlefshme me anën e kryerjes me sukses të mirëmbajtjeve vjetor brenda ciklit të certifikimit. Certifikata ISO 39001-2012 është lëshuar me datë 02 mars 2023, kurse OE Lulishtja Buqaj nuk ka ofruar dëshmi se ka kryer mirëmbajtjen vjetore e cila në bazë të kërkesës së AK është dashur të bëhet deri me datën 16.04.2025.

Pa e kryer mirëmbajtjen, Certifikata ISO 39001-2012 nuk vazhdohet automatikisht, rrjedhimisht për OE Ankues, certifikata e OE Lulishtja Buqaj është e skaduar.

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

? Certifikatat ISO janë ofruar vetëm nga lideri i grupit, mirpo nuk ka paraqit ISO standardet dhe për anëtarin e grupit, duke u bazuar në Rregulloren Nr.001/2023 për Prokurim Publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik, paragrafi 26.6 Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik Certifikatat për sigurimin e cilësisë/ përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e

përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të

certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. “29. 22.06.2023 Sipas nenit 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se AK kërkon Certifikatë që vërteton përshtatshmërinë e produktit me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, në rast grupi të operatorëve, certifikata e tillë a duhet të kërkohej nga të gjithë anëtarët e grupit apo mjafton njëri nga ata të jetë i pajisur me këtë certifikatë?

Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, “Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse 35.Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse”. Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë.

Si i tillë, grupi i konsorciumit i shpallur si pretendent për shpërblimin me kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, oferta e tij duhet të refuzohet dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

Në kërkesën tonë për rishqyrtim të dorëzuar më 07.07.2025, kërkesë e refuzuar më datën 08.07.2025- Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar fare pretendimet tona ndërsa në bazë të Rregullores për prokurimin publik, 62.2 Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.- Shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Si dhe ne piken 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Duke u referuar të pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së: Neni 1 Qëllimi Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës. Neni 65 Provueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 4/4 Udhëzuesin nr.002/2024 për

plotësimin ndryshimin e udhëzuesit nr.001/2023 për prokurimin publik pika 10.1 Sqarimi i tendereve. Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët Ligji Nr. 04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-se. Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet të Prokurimit andaj kërkojmë nga ana juaj si Organ Shqyrtues i prokurimit që të nxjerret: VENDIMI APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE AAB Construction SHPK ANULOHET, vendimi i AK-së dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM, DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimi dhe krashasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 21.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0656/25, ndërsa me datë 03.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0656 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “AAB CONSTRUCTION ” SH.P.K. të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit

- Lidhur me pretendimet e OE “AAB CONSTRUCTION” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0656 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor i OE ankues se Grupi i OE ankues kanë ofruar tender Jo normalisht të ulët i pa bazuar pasi qw ne njoftimin pwr kontratw dhe nw dosjen e tenderit te FDT neni 30.1 Kriteret e Dhënies wshtw “Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6” me nwnkriteret 1. Çmimi me 70% dhe Garancioni i produkteve min 2 – max 5 vite me 30%. Sipas kwsaj kur wshtw tenderi ekonomikisht mw i favorshem nuk vlenw neni 61 pasi qe te tenderi ekonomikisht me i favorshem nwnkriteri i çmimit ka njw peshw tw pwrqindjes dhe totali i të gjitha peshave duhet të jetë i barabartë me 100 poena.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i Ankuesit është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi ankimor i OE ankues se është se Grupi i OE i rekomanduar për kontrat nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë si në vijim:

Kerkesa 2: OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, 2.11 OE duhet të ketë së paku tre (3) punëtorë të trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare- 2. Lista origjinale e punëtorëve të O.E. nënshkruar dhe vulosur nga O.E. 2.11 Për-3 punëtorët e trajnuar për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës të prezantohen Certifikatat kopje si dhe kontratat e punës ose parakontrate në emër të projektit,

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë e tij ka dorëzuar listen e punëtorëve duke ju bashkangjitur deshmimit kontratat për secilin punëtor që është në listen e punëtorëve të dorëzuar nga ofertuesi si dhe certifikatat. Autoriteti Kontraktues konformë nenit 59.2 dhe nenit 72 ka kërkuar sqarime shtesë për tre (3) punëtorë pasi që janë në listen e dorëzuar si dhe kontratat janë të dorëzuara për vitin 2024 dhe që janë të skaduar dhe AK konform nenit 59.2 dhe nenit 72 ka kërkuar sqarime shtesë. Në sqarimet e dorëzuara nga ofertuesi i rekomanduar për kontratë përveq kontratave të vazhduara për këta punëtorë ka dorëzuar edhe Lista e Punëtorëve në ATK-së për vitin 2025 ku për punëtorët që OE ankues pretendon se nuk kanë kontratë për vitin 2025, ofertuesi ka deshmuar me listen e punëtorëve që janë në ATK dhe që ju paguhen tatimet punëtorëve që janë si punonjës të OE “Lulishtëja Buqaj”, si në vijim

po ashtu me sqarime shtesë janë bashkangjitur certifikatat për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës konform nenit 59.2 dhe 72 paragrafi 3 “ Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”. Nga kjo certifikatat për përdorimin dhe manovrimin e mjeteve të punës janë të leshuara para datës së dorëzimit të tenderëve dhe këta tre punëtorë janë në listen e punëtorëve të dorëzuar në ofertë ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimor i Ankuesit është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë si në vijim:

Kerkesa 2: 2.1 O.E. duhet të caktoj me deklaratë të qartë ose me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare- 2.1- Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit dhe udhëheqësin e punishtes, Diplomati, certifikatat e inxhinierit Diplomati jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri origjinal

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë e tij ka dorëzuar listen e stafit profesional duke ju bashkangjitur deshmimit si kontratat, certifikatat, CV-të për secilin inxhinier ku për Udhëheqësin e punishtes janë dorëzuar të gjitha deshmimet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pretendimi ankimor i OE ankues se Udhëheqësi i punishtes ka

çertifikaten për siguri dhe shendet në punë të skaduar çertifikat e leshuar me datën 10.01.2022 për mendimin e ekspertit kjo çertifikatë si dhe të gjitha çertifikatat për siguri dhe shendet në punë të tjera duke përfshirë edhe stafin profesional të OE ankues kan vetëm datën kur është leshuar ndërsa nuk kanë data të skadimit apo ndonjë përshkrim që këto çertifikata janë valide për një, dy apo më shumë vite.

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë si në vijim:

Kërkesa 6: 6. Lista e mjeteve të domosdoshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 8.

Dëshmia e kërkuar dokumentare- 6. - Te prezentohet kopjet e dokumenteve të regjistrimit të paisjeve-libreze valide qarkullimit rrugore apo dokumentet unike doganore apo fatura të blerjes. Në rast se OE nuk I posedon paisjen dhe pronsine, atëherë duhet të prezentohet marreveshje për shfrytëzimin e paisjeve në emer të ketijë projekti e nënshkruar nga të dy palët me kohezgjatje sa projekti me deshmite libreze valide qarkullimit rrugore apo dokumentet unike doganore apo fatura të blerjes.

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë e tij ka dorëzuar listen e mjeteve të domosdoshme për realizimin e projektit duke ju bashkangjitur deshmimit kopje dokumentet e regjistrimit për automjetet rrugore si dhe deshmimi tjetër të kërkuar sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në listen e pajisjeve të kërkuara nga AK është kërkuar Kamion kiper me kran me peshe ngarkese max. 1.5 tonë ndërsa Grupi i OE ka ofertuar me Kamionete kipper me vinç me dy dyer me peshë 350kg, sa i përketë këtij pretendimi ankimor të OE ankues për mendimin e ekspertit ky automjet i ofruar nga Grupi i OE i plotëson kërkesën e AK pasi që AK ka kërkuar kamion me peshe ngarkese max 1.5tone ndërsa Grupi i OE ka ofruar kamionet me 350kg që është brenda kërkesës së AK por vetëm dallon emërtimi i automjetit ndërsa funksionimin e ka të njëjtë si kamioni pasi që është automjete për bartje të mallave me peshe. Për mendimin e ekspertit shqyrtues konform nenit 59.4 (ii) pasi që përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

Pretendimi ankimor i Grupit të OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë si në vijim:

Kërkesa 4: 4.-Certifikim 1. ISO 45001 2018-Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Pune. 2.ISO 9001 2015-Sistemi i menaxhimit të Cilësisë 3.ISO 14001 2015-Sistemet e menaxhimit të Mjedisit. 4. ISO 39001 2012-Sistemet e menaxhimit të Sigurisë në trafikun Rrugor

Dëshmia e kërkuar dokumentare- 4- Çertifikatat të jenë valide dhe të verifikueshme online.

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë e tij ka dorëzuar të gjitha ISO standardet e kërkuara sipas dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në deshmimit e dorëzuara nga Grupi i OE është edhe deshmia çertifikata ISO 39001 2012-Sistemet e menaxhimit të Sigurisë në trafikun Rrugor e cila ISO në bazë të një verifikimi online në faqen ëëë.aqscert.org shfaqet se kjo çertifikatë është valide për më tepër shih si në vijim:

Siç verehet nga foto si më lart në web faqen www.aqscert.org, ISO 39001:2012 është çertifikatë valide.

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.6

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë e tij ka dorëzuar të gjitha ISO standardet e kërkuara sipas dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë pasi që kriteri i kërkuar është të neni 69 i LPP Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Sipas Ligjit të prokurimit publik Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik paragrafi 4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Po ashtu edhe sipas Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024, neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik paragrafi 26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzojë Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Po ashtu edhe paragrafi 26.8 Në rast të furnizimeve, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Çertifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi.

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i pabazuar.

Prandaj mendoj se Autoriteti Kontraktues ka respektuar në tërësi dispozitat e neneve të lartë shenuara të LPP-së si dhe të neneve të Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar e të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“**AAB CONSTRUCTION**” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“**AAB CONSTRUCTION**” SH.P.K.janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“**AAB CONSTRUCTION**” SH.P.K janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik OE“**AAB CONSTRUCTION**” SH.P.K, duhet refuzohet si e pabazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 03.07.2025, për shperblim me kontratë Operatorit ekonomik OE “**N.P.T Lulishtja Buçaj; N.P.T Daqa**”, për aktivitetin prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza”, me numër të prokurimit 616-25-1686-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Komuna Prishtinë.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0656, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE "AAB CONSTRUCTION" SH.P.K vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: